




Republika e Kosovës
Republika Kosova
Republic of Kosovo



Zyra Kombëtare e Auditimit
Nacionalna Kancelarija Revizije
National Audit Office

RAPORTI I AUDITIMIT PËR PASQYRAT FINANCIARE VJETORE TË KOMUNËS SË PEJËS PËR VITIN 2023

Prishtinë, qershor 2024

PËRMBAJTJA E RAPORTIT

- 1 Opinioni i Auditimit
- 2 Gjetjet dhe rekomandimet
- 3 Informacion i përmbledhur për planifikimin dhe realizimin e buxhetit
- 4 Progresi në zbatimin e rekomandimeve

Shtojca I: Letër konfirmimi

Shtojca II: Shpjegim lidhur me llojet e të ndryshme të opinioneve të aplikuara nga ZKA dhe pjesëve të tjera të Raportit të Auditimit

1 Opinioni i Auditimit

Ne kemi përfunduar auditimin e pasqyrave financiare të Komunës së Pejës për vitin e përfunduar më 31 Dhjetor 2023, në përputhje me Ligjin për Auditorin e Përgjithshëm dhe Zyrën Kombëtare të Auditimit të Republikës së Kosovës dhe Standardet Ndërkombëtare të Institucioneve Supreme të Auditimit (SNISA). Auditimi është kryer për të na mundësuar të shprehim opinionin për pasqyrat financiare dhe konkluzionin për pajtueshmërinë me autoritetet.¹

Opinion i kualifikuar për pasqyrat financiare vjetore

Ne i kemi audituar pasqyrat financiare vjetore të Komunës së Pejës (KP), të cilat përmbajnë pasqyrën e pranimeve dhe pagesave në para të gatshme, raportin e ekzekutimit të buxhetit si dhe shënimet shpjeguese për pasqyrat financiare, përfshirë përmbledhjen e politikave të rëndësishme të kontabilitetit dhe raportet tjera², për vitin e përfunduar më 31 dhjetor 2023.

Sipas opinionit tonë, përveç ndikimit të çështjes/ve të përshkruara në paragrafin për Bazën për Opinion të Kualifikuar, Pasqyrat Financiare Vjetore të Komunës së Pejës, prezantojnë një pamje të drejtë dhe të vërtetë në të gjitha aspektet materiale, në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Kontabilitetit për Sektorin Publik, sipas kontabilitetit të bazuar në para të gatshme.

Baza për Opinion të Kualifikuar

B1 Komuna kishte bërë keq klasifikim të shpenzimeve kapitale në vlerë prej 1,032,580€, nga kategori ekonomike jo adekuate. Nga kjo vlerë 937,769€ ishin pagesa të ekzekutuara nga thesari për vendime gjyqësore/përmbarrimore për pagat jubilarë dhe shujta nga kategoria e investimeve kapitale, dhe 30,448€ për mallra dhe shërbime, si dhe nga kategoria e mallrave dhe shërbimeve janë shpenzuar 64,363€ për paga dhe mëditje duke mbivlerësuar/nënvlerësuar llogarite përkatëse.

Më gjerësisht shih nënkapitullin 2.1 Çështjet që ndikojnë në opinion të auditimit

Auditimi është kryer në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Institucioneve Supreme të Auditimit (SNISA). Sipas këtyre standardeve, përgjegjësitë tona janë përshkruar më poshtë tek pjesa e raportit 'Përgjegjësitë e Auditorit për Auditimin e Pasqyrave Financiare'. Në përputhje me ONISA-P-10, SNISA 130, Kodin e Etikës së ZKA-së, si dhe kërkesat e tjera relevante për auditimin e PFV-ve të organizatave buxhetore, ZKA-ja është e pavarur nga subjekti i auditimit. Besojmë se dëshmitë e auditimit që kemi marrë janë të mjaftueshme dhe të duhura për sigurimin e bazës për opinion.

Konkluzion për pajtueshmërinë

Ne kemi audituar nëse proceset dhe transaksionet përcjellëse janë në pajtueshmëri me kriteret e përcaktuara të auditimit që burojnë nga legjislacioni i zbatueshëm për subjektin e audituar në kontekstin e përdorimit të burimeve financiare.

Sipas mendimit tonë, përveç ndikimeve të çështjes/ve të përshkruara në seksionin Baza për Konkluzion të pajtueshmërisë, transaksionet e kryera në procesin e ekzekutimit të buxhetit Komunës së Pejës kanë qenë, në të gjitha aspektet materiale, në përputhje me kriteret e përcaktuara të auditimit që burojnë nga legjislacioni i zbatueshëm për subjektin e audituar në kontekstin e përdorimit të burimeve financiare.

Baza për konkluzion

- A1 Inicimi i procedurave të prokurimit pa fonde të mjaftueshëm.
- A2 Zotimi i mjeteve dhe urdhërblert jo sipas rregullave financiare në vlerë prej 915,000€.
- A3 Në pesë (5) raste janë identifikuar se janë bartur mjete nga një projekt në një projekt tjetër kapital pa vendim paraprak në shumë prej 1,374,052€.
- A4 Mos përmbushja e kërkesës ligjore për inspektimin e pronave të paluajtshme.
- A5 Parregullsi në kontraktimin e qirasë/parkingjeve.
- B2 Vonesa në pagesën e obligimeve financiare.
- B3 Vonesa në përfundimin e punëve të kontraktuara.
- B4 Dobësi në menaxhimin e subvencioneve.

Më gjerësisht shih nënkapitullin 2.2 Çështjet që ndikojnë në konkluzionin e pajtueshmërisë

Auditimi është kryer në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Institucioneve Supreme të Auditimit (SNISA). Sipas këtyre standardeve, përgjegjësitë tona janë përshkruar më poshtë tek pjesa 'Përgjegjësitë e Auditorit për Auditimin e Pasqyrave Financiare'. Në përputhje me ONISA-P-10, SNISA 130, Kodin e Etikës së ZKA-së, si dhe kërkesat e tjera relevante për auditimin e PFV-ve të organizatave buxhetore, ZKA-ja është e pavarur nga subjekti i auditimit. Besojmë se dëshmitë e auditimit që kemi marrë janë të mjaftueshme dhe të duhura për sigurimin e bazës për konkluzion.

Përgjegjësitë e Menaxhmentit dhe të organeve drejtuese/qeverisëse për pasqyrat financiare vjetore

Kryetar i Komunës është përgjegjës për përgatitjen dhe prezantimin e drejtë të Pasqyrave Financiare sipas Standardeve Ndërkombëtare të Kontabilitetit në Sektorin Publik - Raportimi Financiar bazuar në Kontabilitetin e Parasë së Gatshme. Po ashtu, Kryetar i Komunës është përgjegjës edhe për vendosjen e kontroleve të brendshme, të cilat i përcakton si të nevojshme për të mundësuar përgatitjen e Pasqyrave Financiare, pa keq deklarime materiale të shkaktuara, qoftë nga mashtrimi apo gabimi. Kjo përfshinë përmbushjen e kërkesave që burojnë nga Ligji nr. 03/L-048 për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë dhe Rregullorja nr. 01/2017 për Raportim Vjetor Financiar nga Organizata Buxhetore.

Kryetar i Komunës është përgjegjës për të siguruar mbikëqyrjen e procesit të raportimit financiar të Komunës së Pejës.

Përgjegjësia e Menaxhmentit për Pajtueshmërinë

Menaxhmenti i Komunës së Pejës është gjithashtu përgjegjës për përdorimin e burimeve financiare të Komunës së Pejës në përputhje me Ligjin për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësinë dhe të gjitha rregullat dhe rregulloret e tjera të zbatueshme.³

Përgjegjësia e Auditorit të Përgjithshëm për auditimin e PFV-ve

Objektivat tona janë të ofrojmë siguri të arsyeshme nëse pasqyrat financiare si tërësi nuk përmbajnë keq-deklarime materiale, qoftë për shkak të mashtrimit ose gabimit dhe të hartojmë një raport të auditimit që përfshin opinionin tonë. Siguria e arsyeshme është siguri e nivelit të lartë, por nuk është një garanci se një auditim i kryer në përputhje me SNISA-t do të zbulojë çdo keq-deklarim material që mund të ekzistojë. Keq-deklarimet mund të vijnë nga mashtrimi ose gabimi dhe konsiderohen materiale nëse, individualisht ose si tërësi, në mënyrë të arsyeshme pritet të ndikojnë në vendimet ekonomike të përdoruesve të marra në bazë të këtyre pasqyrave financiare.

Objektivi ynë është gjithashtu të shprehim një konkluzion të auditimit për pajtueshmërinë e autoriteteve përkatëse të Komunës së Pejës me kriteret e përcaktuara të auditimit që burojnë nga legjislacioni i zbatueshëm në kontekstin e përdorimit të burimeve financiare, lidhur me subjektin e audituar.

Si pjesë e auditimit në përputhje me Ligjin për ZKA dhe SNISA-të, ne ushtrojmë gjykim dhe skepticism profesional gjatë gjithë auditimit. Ne gjithashtu:

- Identifikojmë dhe vlerësojmë rreziqet e keq-deklarimit material të pasqyrave financiare, qoftë për shkak të mashtrimit ose gabimit, hartojmë dhe kryejmë procedurat e auditimit që i përgjigjen atyre rreziqeve, dhe marrim dëshmi të auditimit që janë të mjaftueshme dhe të përshtatshme për të siguruar bazën për opinionin. Rreziku i mos zbulimit të një keq-deklarimi material që rezulton nga mashtrimi është më i lartë sesa për atë që rezulton nga gabimi, pasi mashtrimi mund të përfshijë manipulim, falsifikim, lëshime të qëllimshme, keq përfaqësime ose anashkalim të kontrolleve të brendshme.
- Identifikojmë dhe vlerësojmë rreziqet e mos-pajtueshmërisë me autoritetet, qoftë për shkak të mashtrimit ose gabimit, hartojmë dhe kryejmë procedurat e auditimit që janë përgjegjëse ndaj atyre rreziqeve, dhe marrim dëshmi të auditimit që janë të mjaftueshme dhe të përshtatshme për të siguruar bazën për konkluzionin tonë për pajtueshmërinë me autoritetet. Rreziku i mos zbulimit të një rasti të mos pajtueshmërisë me autoritetet që vjen nga mashtrimi është më i lartë sesa për atë që rezulton nga gabimi, pasi mashtrimi mund të përfshijë manipulim, falsifikim, lëshime të qëllimshme, keq përfaqësime ose anashkalim të kontrollit të brendshëm.
- Sigurohemi ta kuptojmë kontrollin e brendshëm relevant për auditimin, për t'i hartuar procedurat e auditimit që janë të përshtatshme, por jo me qëllim të shprehjes së një opinionimi mbi efektivitetin e kontrollit të brendshëm të Komunës së Pejës.
- Vlerësojmë përshtatshmërinë e politikave të kontabilitetit të përdorura dhe arsyeshmërinë e vlerësimeve të kontabilitetit dhe shpalosjet e ndërlidhura të bëra nga menaxhmenti.

- Vlerësojmë prezantimin e përgjithshëm, strukturën dhe përmbajtjen e pasqyrave financiare, përfshirë shpalosjet, për t'u siguruar se pasqyrat financiare paraqesin transaksionet dhe ngjarjet themelore në mënyrë të drejtë dhe të saktë.

Ndër të tjera, ne komunikojmë me menaxhmentin dhe ata që janë përgjegjës për qeverisjen edhe në lidhje me fushëveprimin dhe kohën e planifikuar të auditimit dhe gjetjet e rëndësishme të auditimit, përfshirë ndonjë mangësi domethënëse në kontrollin e brendshëm që ne e identifikojmë gjatë auditimit.

Nga çështjet e komunikuar me menaxhmentin, ne përcaktojmë ato çështje që ishin më të rëndësishme në auditimin e Pasqyrave Financiare të periudhës aktuale dhe që cilësohen si çështje kyçe të auditimit. Raporti i auditimit publikohet në ueb faqen e ZKA-së, me përjashtim të informacioneve që klasifikohen si senzitive apo për shkak të ndalesave të tjera ligjore e administrative, në pajtim me legjislacionin në fuqi.

2 Gjetjet dhe rekomandimet⁴

Gjatë auditimit, kemi vërejtur fusha ku nevojitet përmirësim për menaxhimin financiar dhe kontrollin e brendshëm. Procesi i raportimit në Komunë ishte përcjell me mangësi, kjo ishte vërejtur edhe me rastin e përgatitjes së Pasqyrave Vjetore Finaciare (PVF). Pas kërkesës sonë disa çështje të ngritura në PVF-të janë korrigjuar dhe dorëzuar në MF. Megjithatë gjatë procesit të auditimit kemi evidentuar mangësi në menaxhimin e pasurive, të hyrave, llogarive të arkëtushme, subvencioneve, ekzekutimin dhe klasifikimin e shpenzimeve, menaxhimin e projekteve kapitale si dhe në procedurat e prokurimit publik të cilat janë paraqitur me poshtë në forme të gjetjeve dhe rekomandimeve. Këto gjetje dhe rekomandime kanë për qëllim të bëjnë korrigjimin e nevojshëm të informacionit financiar të paraqitur në pasqyrat financiare, duke përfshirë shpalosjet në formë të shënimeve shpjeguese dhe të përmirësojnë kontrollet e brendshme lidhur me raportimin financiar dhe pajtueshmërinë me autoritetet në lidhje me menaxhimin e fondeve të sektorit publik. Ne do t'i përcjellim (shqyrtojmë) këto rekomandime gjatë auditimit të vitit të ardhshëm.

Shuma e pagesave të realizuara nga Thesari, në bazë të vendimeve gjyqësore/përmbarimore për kontratën kolektive ishte 1,181,910€. Prej tyre borxhi kryesor ishte 839,963€, ndërsa 341,947€ ishin shpenzime të interesit dhe procedurale të gjykatës/përmbarimi.

Ky raport ka rezultuar me 12 rekomandime, prej tyre pesë (5) janë rekomandime të reja, 6 të përsëritura dhe 1 pjesërisht i përsëritur.

Derisa për statusin e rekomandimeve të vitit paraprak dhe nivelin e zbatimit të tyre, shih kapitullin 4.

2.1 Çështjet që ndikojnë në opinionin e auditimit

Çështja B1 - Klasifikimi jo adekuat i shpenzimeve

Gjetja

Rregulla Financiare Nr. 01/2013/MF “Mbi shpenzimin e parasë publike”, neni 18 pika 3 specifikon se shpenzimet duhet të kenë kodet adekuate, të përcaktuara me Udhëzimin Administrativ për planin kontabël. Rrjedhimisht, neni 11 i UA 19/2009 për planin kontabël, kërkon nga ZKA dhe ZKF që të sigurojnë që të gjitha transaksionet janë regjistruar në SIMFK sipas strukturës së planit kontabël dhe klasifikimeve të përcaktuara me këtë UA.

Komuna ka paguar dhe regjistruar shpenzime në vlerë 1,032,580€ në kategori jo adekuate:

- Nga kategoria investimet kapitale janë paguar për paga dhe mëditje në vlerë prej 937,769€ (vendimeve gjyqësore) si dhe për mallra dhe shërbime në vlerë prej 30,448€; dhe
- Nga kategoria mallra dhe shërbime janë paguar për paga dhe mëditje/shujta në vlerë prej 64,363€ (vendimeve gjyqësore).

Pagesat për paga jubilarë dhe shujta kanë ndodhur si rezultat i kontratës kolektive shpenzimet e të cilave nuk janë planifikuar në buxhet.

Ndikimi

Planifikimi dhe realizimi i shpenzimeve nga kategoritë ekonomike jo adekuate, ndikon në mbivlerësimin/nënvlerësimin e kategorive përkatëse të shpenzimeve dhe të pasurive. Si rrjedhojë ndikon në prezantim jo të drejtë të shpenzimeve në PVF.

Rekomandimi B1

Kryetari duhet të sigurojë që janë ndërmarrë të gjitha veprimet e nevojshme që shpenzimet të planifikohen në ndarjet adekuate të buxhetit apo të bëhet ri-destinimi i mjeteve dhe që pagesa dhe regjistrimi i shpenzimeve të bëhet sipas kodeve ekonomike adekuate të përcaktuara me plan kontabël.

Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Pajtohen)

2.2 Çështjet që ndikojnë në konkluzionin e pajtueshmërisë

Çështja A1 - Inicimi i procedurave të prokurimit pa fonde të mjaftueshëme

Gjetja Ligjit nr. 03/L-221 për Ndryshimin dhe Plotësimin e Ligjit nr. 03/l-048 për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë, neni 36, paragrafi 1 përcakton se "Para inicimit të një procesi të prokurimit i cili ka për qëllim të rezultojë në ngritjen e një obligimi në vitin fiskal, Organizata Buxhetore i regjistron të gjitha zotimet e fondeve të ndara në Sistemin Informativ për Menaxhimin Financiar në Kosovë në përputhje me rregullat.

Gjatë testimeve, kemi vërejtur se në shtatë (7) raste, Komuna kishte hyrë në obligime kontraktuale pa fonde të mjaftueshme. Rastet si në vijim:

- "Ndërtimi i ujësjellësit për fshatrat e Lugut të Baranit" me vlerë të kontratës prej 1,377,859€, deri sa zotimi i mjeteve ishte 200,000€;
- LOT 1 "Ndërtimi dhe asfaltimi i rrugës "Varri i Sykut - Bellopaq" me vlerë të kontratës prej 918,214€, deri sa zotimi i mjeteve ishte 50,000€;
- Kubezimi i trotuareve dhe rregullimi i hapësirave në Treboviq, Katund i Ri dhe Bllagaj me vlerë të kontratës prej 356,794€, deri sa zotimi i mjeteve ishte 140,000€;
- Sanimi dhe rregullimi i infrastrukturës rrugore, murit të kanalit atmosferik, kanalizimit dhe ujësjellësit në rrugën "Azem Bejta" lagjja Asllan Qeshme në Pejë me vlerë të kontratës prej 268,000€, deri sa zotimi i mjeteve ishte 100,000€;
- "Ndërtimi i palestrës në Zahaq" me vlerë të kontratës prej 855,855€, deri sa zotimi i mjeteve ishte 100,000€;
- "Ndërtimi i pendës në fshatin Vranoc" me vlerë të kontratës prej 315,711€, deri sa zotimi i mjeteve ishte 100,000€; si dhe
- "Rregullimi i Segmentit të rrugës dhe mureve mbrojtëse në fshatin Novoselë" me vlerë të kontratës prej 64,721€, deri sa zotimi i mjeteve ishte 3,452€.

Kjo dukuri ka ndodhur si rezultat i mungesës së kontrolleve me rastin e inicimit të procedurave të prokurimit pa pasur zotim të mjeteve.

Ndikimi Hyrja në obligime pa siguruar fondet e nevojshme, ndikon në rritjen e obligimeve të papaguara, apo implikime buxhetore për vitin aktual, si dhe ngarkesë për buxhetin e vitit vijues.

Rekomandimi A1 Kryetari duhet të forcojë kontrollet gjatë vlerësimit të projekteve, duke siguruar që para inicimit të procedurave të prokurimit për çdo projekt kapital të ketë fonde të mjaftueshme për realizimin e projekteve.

Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Pajtohen)

Çështja A2 - Zotimi i mjeteve dhe urdhër blerjet jo sipas rregullave financiare

Gjetja Rregulla Nr.01/2013/MF për Shpenzimin e Parasë Publike, neni 22 përcakton; hapat që fillimisht duhet të procedohet zotimi i mjeteve, lëshohet urdhër blerja dhe pas pranimit të blerjeve bëhet raporti i pranimit, pranohet fatura dhe në fund procedohet për pagese nga Thesari.

Gjatë testimeve, kemi identifikuar se:

- Në pesë (5) raste, në vlerë të pagesave 184,888€ zotimi i mjeteve ishte bërë pas pranimit të mallit apo shërbimit/punëve dhe pranimit të faturës; dhe
- Në 11 raste, në vlerë të pagesave 730,113€, urdhër blerjet ishin bërë pas pranimit të mallit apo shërbimit dhe pranimit të faturës.

Kjo dukuri ka ndodhur për faktin që nuk janë zbatuar rregullat për shpenzimin e parasë publike nga ana e zyrtarëve përgjegjës, si dhe nga mos planifikim i duhur i rrjedhës së parasë.

Ndikimi Hyrja në obligime pa siguruar fondet e nevojshme, ndikon në rritjen e obligimeve të papaguara, apo implikime buxhetore për vitin aktual, si dhe ngarkesë për buxhetin e vitit vijues.

Rekomandimi A2 Kryetari duhet të sigurojë se respektohen hapat e përcaktuar me rregullat në fuqi sa i përket realizimit të pagesave në mënyrë që gjatë procedimit të pagesave, të bëhet fillimisht zotimi i mjeteve, pastaj të nxirret urdhër blerja dhe në fund të pranohet puna/shërbimi dhe të kryhet pagesa.

Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Pajtohen)**Çështja A3 - Ndryshimet në shumat e ndara buxhetore për projektet ekzistuese**

Gjetja Ligji nr. 08/L-193 Ndarjet buxhetore për vitin 2023, neni 16 pika 11 përcakton se; Ndryshimet në shumat e ndara buxhetore për projektet ekzistuese si rezultat i transfereve dhe/ose rialokimeve, të prezantuara në tabelën 4.2., duke përfshirë edhe të hyrat vetanake të bartura, si dhe të regjistruara në SIMFK, duhet të aprovohen paraprakisht nga Kuvendi Komunal, Rialokimet duhet të kryhen në përputhje me procedurat dhe kriteret e parapara me UA MF. nr. 05/2019 për procedurat e transferit dhe rialokimit të ndarjeve buxhetore.

Në pesë (5) projekte komuna ka përdorë fondet nga një projekt në tjetrin për të cilat nuk ishin planifikuar këto fonde. Shuma totale e këtyre projekteve të financuara ishte 1,374,052€. Ne nuk kemi vërejtur se ka aprovim nga Kuvendi Komunal për ri-destinim të mjeteve dhe ri-alokimit të ndarjeve buxhetore nga një projekt kapital në një tjetër.

Kjo ka ndodhur si rezultat i menaxhimit jo të mirë të buxhetit, ekzekutimit dhe monitorimit të projekteve kapitale.

Ndikimi Shfrytëzimi i fondeve nga një projekt për pagesën e obligimeve të projektit tjetër duke anashkaluar procedurat ligjore rritë rrezikun që projektet e aprovuara të mos realizohen dhe në mos arritjen e objektivave të komunës.

Rekomandimi A3 Kryetari duhet të sigurojë se janë marrë veprimet e nevojshme që projektet e aprovuara të realizohen sipas planifikimit. Nëse paraqitet nevoja për ridestinim të fondeve të projekteve, kjo të realizohet përmes procedurave të përcaktuara me rialokim në pajtim me Ligjin mbi ndarjet buxhetore.

Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Pajtohen)

Çështja A4 - Mos përmbushja e kërkesës ligjore për inspektimin e pronave të paluajtshme

Gjetja Bazuar në Ligjin Nr. 06/L-005 Për Tatimin në Pronën e Paluajtshme, neni 15 pika 1 dhe 2 përcakton se: Inspektimi 1. Komuna inspekton pronat e paluajtshme brenda territorit të Komunës. Komuna mund të angazhojë inspektor privat për të ndihmuar në veprimtaritë inspektuese, 2. Veprimtaritë inspektuese kryhen çdo vit për të paktën njëzetë përqind (20%) të të gjitha objekteve brenda territorit të Komunës dhe vetëm kur është e nevojshme për parcelat.

Komuna në vitin 2023 për tatimin në pronë të objekteve në sistemin Protax kishte të evidentuar 43,539 objekte/prona, prej e cilave 764 prona të reja. Ne kemi vërejtur se komuna nuk kishte bërë asnjë inspektim (verifikimin) të pronave të paluajtshme, siç kërkohet nga ligji në fuqi.

Komuna nuk ka ndërmarrë të gjitha masat ose veprimet alternative për verifikimin e 20% të pronave të paluajtshme/objekteve.

Ndikimi Mos aplikimi i kërkesës ligjore për inspektim të pronës së paluajtshme rezulton në mungesë të informacionit të sakta mbi pronën e tatueshme. Kjo situatë mundëson rrjedhjen e gabimeve në vlerësim, duke mos reflektuar gjendjen faktike në teren në krahasim me atë të evidentuar në Protax. Gjithashtu, kjo mungesë e informacionit mund të ndikojë në vlerësimin jo të saktë të të ardhurave për tatimin në pronë.

Rekomandimi A4 Kryetari duhet të sigurojë arritjen e verifikimit të 20% të pronave të paluajtshme në mënyrë që ndryshimet eventuale të pronave të integrohen në bazën e të dhënave për të reflektuar detyrimin e saktë tatimor.

Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Pajtohen)

Çështja A5 - Parregullësi në kontraktimin e qirasë/parkingjeve**Gjetja**

Sipas kushteve të kontratave për dhënien në shfrytëzim afatshkurtër të pronës së paluajtshme komunale /për parkingje, të lidhura midis Komunës dhe OE me kohëzgjatje prej 10 viteve, përcaktohet: shfrytëzimi i pronës fillon menjëherë pas nënshkrimit të kontratës (datën e fillimit dhe mbarimit), pagesa e qirasë (qiramarrësi obligohet që para nënshkrimit të kësaj kontrate të paguaj shumën prej 50% të shumës vjetore, për 6 muajt vijues dhe pjesën tjetër prej 50% në 6 mujorin e dytë, qiraja vjetore paguhet në dy këste vjetore (p.sh. Mars -Shtator).

Ligji Nr. 06/L-092 Për dhënien në shfrytëzim dhe këmbimin e pronës së paluajtshme të komunës, neni 14, pika 2 taksativisht përcakton se propozimi për dhënien në shfrytëzim të pronës së paluajtshme të komunës, duhet të identifikojë të dhënat kadastrale të pronës, madhësinë e saj, të specifikojë arsyet, qëllimin, kohëzgjatjen si dhe formën në të cilën rekomandohet procesi për dhënien e pronës në shfrytëzim.

Komuna ka lidh kontrata afatshkurtër 10 vjeçare për dhënien me qira të parkingjeve, ku janë identifikuar dobësi si në vijim:

- Në tre (3) raste kontrata me nr. 064/2022, aneks kontrata me nr.15-400/01-111764/23 dhe aneksi tjetër me nr. 046/01-7867 janë nënshkruar pasi ka filluar periudha e aplikimit të qirasë. Për me tepër sipas kontratës bazë me nr. 046/22 të datë 01.06.2022 vlera për pagesën të qirasë 153,639€ ka pësuar ndryshim duke e zvogëluar vlerën e pagesës së qirasë pas 12 muajve me Aneksin 1 (aplikimi i pagese nga dt. 01.06.23) në 137,203€ dhe po ashtu me aneksin i dytë (2) prapë pas 19 muajve është zvogëluar vlera e pagesës për qiranë në 115,639€ (aplikimi i pagese prej 01.01.2024); dhe
- Në tre (3) raste, tek kontratat me nr. 64/22 periudha e qirasë 01.07.2022-31.06.2032, 045/22 periudha e qirasë 01.06.2022-31.05.2032 dhe 046/22 periudha e qirasë 01.06.2022-31.05.2032, pagesa e parë prej 50% është kërkuar si paradhënie apo para se të nënshkruhet kontrata, edhe pse në kontratë përcaktohet kohëzgjatja dhe fillimi i periudhës së shfrytëzimit të qirasë. Edhe përkundër që kësti i parë është paguar si paradhënie, para se palët të hyjnë në obligime kontraktuale, afatet për pagesën e kësteve vjetore janë precizuar marsi dhe shtatori.

Shkak i mangësive ishin kontrollet jo funksionale dhe kompetenca jo duhur e stafit.

Ndikimi

Nënshkrimi i vonuar i kontratave, pagesat para hyrjes në obligime kontraktuale dhe definimi jo i qartë i afatit për pagesë kanë rezultuar me menaxhim të dobët të këtyre kontratave/pagesave. Aneksi i kontratës për Lotin 1 ka rezultuar me ndryshimin e kushtit fillestare të Kontratës për pagesë apo zvogëlimin e pagesës prej 25%, krahasuar me kontratën bazë.

Rekomandimi A5

Kryetari të sigurojë se kontrollet e vendosura janë funksionale, kontratat të nënshkruhen para fillimisht të periudhës së qirasë duke precizuar afatin e pagesës, periudhën kohore të rrjedhës së obligimeve kontraktuale, si dhe të fillon të zbatohet me nënshkrimin e kontratës, dhe propozimi për dhënien në shfrytëzim të pronës duhet identifikoj paraprakisht sipërfaqen e pronës

së dhënë për qira.

Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Pajtohen)

Çështja B2 - Vonesa në pagesën e faturave

Gjetja Ligji nr. 03 /L-048 për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë, neni 39.1 përcakton që secila faturë e vlefshme dhe kërkesë për pagesë të mallrave dhe shërbimeve të paguhet brenda 30 ditëve kalendarike pas marrjes së faturës.

Në tre (3) raste, faturat në vlerë totale prej 118,296€ të paraqitura në PVF, përfaqësojnë fatura të papaguara për më shumë se 30 ditë, me vonesë nga 20 ditë deri në 8 muaj.

Shkak i mos pagesës me kohë të detyrimeve, ishte planifikim jo i mirë i buxhetit dhe inicimi i procedurave të shpenzimeve pa mjete në dispozicion, si dhe mungesa e komunikimit në mes të zyrtarëve përgjegjës.

Ndikimi Si pasojë e vonesave në pagesën e faturave, komuna mund të përballet me kosto shtesë të interesave e gjobave për vonesat e shkaktuara të kërkuara nga palët e treta.

Rekomandimi B2 Kryetari duhet të përmirësojë menaxhimin e fondeve për të siguruar që obligimet financiare të kryhen në kohë dhe brenda afatit prej 30 ditëve, duke përfshirë hartimin e një analize të hollësishme buxhetore për të shmangur vonesat në pagesat e faturave.

Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Pajtohen)

Çështja B3 - Vonesa në përfundimin e punëve të kontraktuara

Gjetja Me kontratën publike të nënshkruar mes komunës dhe kontraktuesit, përcaktohen kushtet e veçanta kontraktuale si dhe afati kohor për realizimin e projektit. Menaxherët e kontratave duhet të monitorojnë dhe të sigurojnë se kontratat po realizohen si duhet dhe në afatin e përcaktuar.

Në pesë (5) raste, kemi evidentuar vonesa në realizimin e projekteve, si në vijim:

- Kontrata "Ndërtimi i ujësjellësit për fshatrat e baranit" në vlerë 1,377,859€, e nënshkruar më datë 14.06.2023, nuk është kryer sipas planit dinamik prej 150 ditë;
- Kontrata "Ndërtimi i sallës sportive në shkollën 2 korriku në Logje" në vlerë 175,617€, e nënshkruar më datë 23.05.2023, nuk është kryer sipas planit dinamik prej 120 ditë;
- Kontrata "Asfaltimi i rrugëve për komunitetet në Vitomericë" në vlerë 384,794€, e nënshkruar më datë 22.06.2023, nuk është kryer sipas planit dinamik prej 90 ditë;
- Kontrata "Sanimi dhe rregullimi i infrastrukturës në rrugën Azem Bejta" në vlerë 268,000€, e nënshkruar më datë 27.07.2023, nuk është kryer sipas planit dinamik prej 60 ditë; dhe
- Kontrata "Asfaltimi i rrugës stacioni i autobusëve" në vlerë 78,480€,

e nënshkruar më datë 27.06.2023, nuk është kryer sipas planit dinamik prej 60 ditë.

Deri sa ishim nën auditim (mars 2024) asnjëra nga këto projekte nuk ishin të përfunduar. Po ashtu bazuar në të dhënat e komunës rreth 25 projektet të cilat përfshijnë periudhën 2020 deri 2022 nuk ishin finalizuar ende.

Shkak i vonesave ishte mungesa e mjeteve në dispozicion për të përfunduar kontratën si pasojë e planifikimit jo të duhur të projektit, si dhe të disa problemeve në shpronësimin e pronave.

Ndikimi Vonesat në kryerjen e projekteve ndikojnë në rritjen e obligimeve kontraktuese të cilat mund të kenë implikime buxhetore për buxhetin e vitit pasues. Kjo, po ashtu, ndikon në performancën dhe mos arritjen e objektivave të përcaktuara të Komunës.

Rekomandimi B3 Kryetari duhet të sigurojë vendosjen e kontrolleve në këtë fushë me një mbikëqyrje rigoroze në menaxhimin e kontratave. Realizimi i kontratave të bëhet në përputhje me planin dinamik/afatin për kryerjen e punëve/furnizimeve dhe për vonesat e pa arsyetuara, të aplikohen masat/ndëshkimet e parapara në kontratë.

Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Pajtohen)

Çështja B4 - Dobësi në menaxhimin e subvencioneve

Gjetja Rregullorja MF-Nr.04/2017- mbi kriteret, standardet dhe procedurat e financimit publik të Organizatës Jo Qeveritare (OJQ), neni 23, paragrafi 1 përcaktohet se; Monitorimi dhe raportimi projekteve dhe programeve, ku për secilën kontratë të lidhur, ofruesi i mbështetjes financiare cakton një zyrtar përgjegjës i cili duhet kujdeset për monitorimin e implementimit të projektit. Raportimi përfshin raporte narrative dhe financiare dhe periudhat raportuese do të përcaktohen me dispozitat e kontratës me përfituesin.

Nga mostrat e testuar, në tre (3) raste, ofruesi i mbështetjes financiare nuk ka caktuar zyrtar përgjegjës i cili duhet kujdeset për monitorimin e implementimit të projektit. Po ashtu, këta përfitues nuk kanë dorëzuar raporte financiare dhe narrative për vitin 2023. Rastet e mos dorëzimit të raporteve narrative ishin përfituesit e OJQ-ve njëra në vlerë prej 38,294€ dhe dy të tjera përfitues të subvencioneve nga 15,000€.

Shkaku ishte mungesa e kontrollove të brendshëm dhe mekanizmat e krijuar nga menaxhmenti për të adresuar kërkesat rregullative.

Ndikimi Mos caktimi i zyrtarëve përgjegjës të cilët duhen të kujdesen për monitorimin e implementimit të projektit, si dhe mos dorëzimi i raporteve narrative dhe financiare për periudhat raportuese, ndikon negativisht dhe krijon vështirësi në menaxhimin e mirëfilltë të subvencioneve.

Rekomandimi B4 Kryetari duhet të ndërmerrë masa në krijimin e mekanizmave të duhur për të siguruar që zyrtarët përgjegjës të kujdesen për monitorimin e implementimit të projekteve. Praktikisht, të siguroj se OJQ-të përfituese të subvencioneve të dorëzojnë raporte financiare dhe narrative.

Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Pajtohen)

2.3 Çështjet tjera të menaxhimit financiar dhe të pajtueshmërisë

2.3.1 Investimet kapitale

Buxheti final për investime kapitale ishte 15,503,693€, prej tyre ishin shpenzuar 14,592,995€. Shpenzimet në këtë kategori kanë të bëjnë me ndërtimin e rrugëve lokale, objektet arsimore, mirëmbajtje investive, pajisje tjera etj.

Çështja B5 - Dobësi në menaxhimin e projekteve përmes platformës elektronike të e-prokurimit

Gjetja Rregullorja nr. 001/2022 për prokurimin publik neni 70.24 pika (f) parasheh se menaxherët e kontratës “Të sigurojnë që të gjitha regjistrat e menaxhimit të kontratës të përgatiten, mbahen dhe arkivohen në modulën për menaxhim të kontratës në sistem të prokurimit elektronik.

Nga testimet e bëra, ka rezultuar se në tre (3) raste, menaxhimi i kontratave dhe vlerësimi i performancës së kontraktuesve nuk është mbajtur dhe arkivuar përmes sistemit elektronik të prokurimit publik (e-prokurimi), si:

- Ndërtimi i ujësjellësit për fshatrat e Lugut të Baranit - ri tender në shumë prej 1,377,859€;
- LOT 1 “Ndërtimi dhe asfaltimi i rrugës “ Varri i Sykut - Bellopaq” në shumë prej 918,214€; dhe
- “Punimi dhe furnizimi me reklamave ndriçuese të standardizuara 3D” në shumë prej 9,800€.

Kjo ka ndodhur si pasojë e anashkalimit të përdorimit të procedurës së kërkuar nga zyrtarët përgjegjës.

Ndikimi Mos mbajtja dhe arkivimi i kontratave përmes sistemit të prokurimit publik, mund të ndikoj në një menaxhim jo të mirëfillt të kontratave, si dhe nuk ofron mundësi e mjaftueshme që menaxhmenti apo përdoruesit e lejuar të marrin informata me kohë reale në lidhje me progresin dhe menaxhimin performancën e kontratave.

Rekomandimi B5 Kryetari duhet të rishikojë shkaqet e mos përdorimit të sistemit e-prokurimi dhe të ndërmarrë masa shtesë të kontrollit apo nevojave tjera, për të siguruar që menaxhimi i kontratave do të mbahet dhe arkivohet në sistemin elektronik të prokurimit publik.

Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Pajtohen)

2.3.2 Pasuritë kapitale dhe jokapitale

Vlera neto e pasurive kapitale e paraqitur në PFV e vitit 2023 është 358,437,588€, pasurive jokapitale është 595,486€ si dhe e stoqeve 64,119€.

Çështja B6 - Mos regjistrimi i pasurive dhe mos hartimi i një rregullore të brendshme për menaxhimin e pasurive jo financiar

Gjetja

Rregullorja Nr. 02/2013 “Për menaxhimin e pasurisë jo financiare në organizatat buxhetore”, neni 6 përcakton se: pasuria kapitale duhet të regjistrohet në SIMFK, ndërsa pasuria jo kapitale dhe stoqet duhet të regjistrohet në sistemin “e-pasuria”. Po ashtu Nneni 7 pika 1 i rregullores përcaktonarash se: të gjitha lëvizjet e pasurive jo financiare (pranimi, shitja, dhurimi, transferimi dhe asgjësimi) të cilat rezultojnë në ndryshimin e përgjegjësisë menaxheriale dhe përdorimit duhet të mbështeten në dokumente përkatëse. Ndërlidhur me këtë, po ashtu paragrafi 10 përcakton se : Për të gjitha vendimet e marra, komisioni për tjetërsimin e Pasurisë jo Financiare do të njoftojë zyrtarin e pasurive dhe do t'i dorëzojë një kopje të të gjithë dokumentacionit lidhur me procesin e tjetërsimit.

Sipas shënimeve të Thesarit vlera e tokës e përvetësuar nga Komuna në vitin 2023 ishte 706,539€, deri sa vlera prej 385,130€ nuk ishte regjistruar në regjistrat kontabël. Si dhe, në tre (3) raste janë evidentuar, pasurit jo kapitale të blera në vlerë prej 15,917€, të cilat nuk ishin regjistruar në sistemin e-pasuria.

Sipas analizës së regjistrat kontabël të pasurive kapitale është vërejtur se në kuadër të kodit ekonomik “32500 Investimet në vijim” nuk janë mbyllur projektet të cilat janë finalizuar nga viti 2016 deri në vitin 2023 në shumë prej 24,476,550€, përkundër angazhimit të zyrtarit të pasurisë.

Po ashtu, në tre (3) raste kemi identifikuar se Komuna përmes komisioneve përkatëse ka vendosur për tjetërsimin e pasurive kapitale të një aparati për ngrohje, një automjet ishte dhuruar entit higjenik dhe një autoambulance ishte shitur, ku vlera kontabël e tyre ishte zero. Ne nuk kemi gjetur se komisioni përkatës ka dorëzuar ndonjë raport lidhur me procesin e tjetërsimit e pasurive dhe nuk ka njoftuar zyrtarin e pasurisë për aplikimin e procedurave tjera për largimin e pasurive të tjetërsuara nga regjistri i përgjithshëm i pasurive kapitale.

Mos regjistrimi i shpronësimit të tokës si pasuri kapitale në SIMFK ka ndodhur për shkak të mos identifikimit të pronarit të tokës, ndërsa ato pasuri nën 1 mijë euro nuk janë regjistruar në e-pasuri nga mungesa e komunikimit të ndërsjellët në mes detyrave të caktuara të zyrtarëve përgjegjës.

Ndikimi

Mungesa e regjistrave të saktë dhe të plotë si dhe mos hartimi një rregullore të brendshme për pasuritë jo financiare, shkakton mungesë të informatave për menaxhimin lidhur me pasurinë që ka në dispozicion komuna, shkakton mbi/nënvlerësim të pasurive si dhe mund të rezultojë në prezantimin jo të drejtë dhe të plotë të informatave në PVF.

Rekomandimi B6

Kryetari duhet të sigurojë se të gjitha pasuritë e komunës janë regjistruar saktë në regjistrat përkatës të pasurive komunale, sipas kërkesave të Rregullores 02/2013 për menaxhimin e pasurive jo financiare në organizatat buxhetore. Po ashtu, duhet të sigurojë hartimin e një rregullore

të brendshme për menaxhimin e pasurive jo financiare, e cila duhet të përfshijë rregulla dhe procedura të qarta për identifikimin, dokumentimin, mbajtjen, tjetërsimin dhe raportimin e pasurisë jo financiare.

Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Pajtohen)

2.3.3 Të arkëtueshmet

Komuna e Pejës në PVF e vitit 2023 kishte shpallur llogari të arkëtueshme në vlerë prej 23,544,860€. Krahasuar me vitin e kaluar (vlera e të arkëtueshmeve ishte prezantuar prej 21,633,930€/2022) kjo vlerë është rritur prej 1,910,930€ apo këto llogari tregojnë trend rritës prej 8.8%. Kjo vlerë përbëhet nga tatimi në pronë, qiratë, taksa në biznese etj.

Çështja C1 - Rritja e llogarive të arkëtueshme si pasojë e vonesave në arkëtimin e të hyrave

Gjetja

Ligji nr.06/L-005 -Për tatimin në pronë e paluajtshme, neni 23 përcakton se; Paguesa e detyrimeve tatimore dhe shpërndarja e pagesave, Për vitin tatimor 2019 dhe vitet tatimore në vijim, tatimi dhe gjopa, nëse ka të këtillë, paguhet me dy këste të barabarta, deri më 30 prill dhe 30 shtator të vitit tatimor. Po ashtu, tek kushtet e kontratave mbi shfrytëzimin e përkohshme të tokës komunale/një vjeçare, parasheh; iniciimin e procedurës për largime dhe tërheqjen e lejes nëse nuk paguan qiranë brenda 15 ditëve. Po ashtu edhe kushte e kontratave për parkingje, përcakton mbikëqyrjen dhe raportin e ecurisë për zbatimin e kontratës duke rekomanduar Kryetarit marrjen e masave në rast të mos përmbushjes së kontratës.

Testimet e bëra në këtë kategori vërehet trend i rritjes së LLA.

- Në këto llogari, pjesëmarrje më të lartë ka tatimi në pronë prej 16,757,735€ apo 71%, ku nga 50 mostrat e testuar 45 raste tatimpaguesit kanë borxhe të prapambetura apo nuk kanë paguar me kohë tatimin në pronë;
- Nga 15 rastet e audituar të qirasë/shfrytëzimi i përkohshme i hapësirave publike dhe vendosja e panove reklamuese, sipas kontratave/vendimeve, kemi vërejtur që në 5 raste obliguesit kishin borxhe të pa paguara që janë prezantuar si llogari të pa arkëtuar të qirasë në vlerë prej 44,917€;
- Në dy raste sipas kontratave 046/ loti 1 dhe 045/22/ loti 2 të qirasë për hapësira publike/parkingjet me afat 10 vjeçar po ashtu kanë vonesa/borxhe të cilat me rekomandimin e auditorit janë prezantuar në PFV.
- Të arktushmete nga taksa në biznes prej 6,391,030€ kanë të bëjnë me ngarkesat nga vitet e mëparshme nga 2002-2012, për të cilat që nga 2017 palët më nuk kanë paguar për të njëjtën taksë dhe Komuna nga viti 2012 nuk faturon më këtë taksë, mirëpo është duke shqyrtuar mundësin për menaxhimin e tyre me ndihmën e USAID-it.
- Kërkesat nga padit gjyqësore të prezantuar si llogari të arkëtueshme në vlerë prej 126,989€ (gjendje e njëjtë është prezantuar edhe në dy vitet paraprake), Komuna nuk ka ofruar dëshmi/ të dhëna mbi natyrën e këtyre llogarive që pret ti inkasoj në të ardhmen. Në mungesë të dëshmive, auditori nuk ofron mendim për të njëjtën situatë.

Kontrollet jo të duhura tek shfrytëzimi i hapësirave publike dhe vendosja e panove reklamuese, heqja e pezullimeve dhe proceduarve përmbartimore shkaktuar rritjen e llogarive të arkëtueshme. Shkak tjetër është se Departamenti i Tatimit në Pronë, Ministria e Financave me dt.21.06.23 ka njoftuar për heqjen e pezullimeve për shërbime komunale dhe përdorimin e procedurave përmbartimore private. Po ashtu ka të bëjë edhe me gjendjen ekonomike të qytetarit/taksapaguesit të komunës për ti kryer obligimet e tatimit / të kontraktuar ndaj Komunës.

Ndikimi Rritja e llogarive të arkëtueshme reflekton me më pak fonde për arritjen e objektivave të Komunës, apo rikthimin e investimeve në interes të qytetarëve. Kjo rezulton me pamundësinë e vjeljes së këtyre të hyrave për shkak të vjetërsimit në disa raste.

Rekomandimi C1 Kryetari duhet të sigurojë kontrolle efikase në arkëtimin e të hyrave dhe mbledhjen e të arketushemeve. Masat e parapara në kontratë/ shkëputje të kontratës duhet të zbatohen me qëllim të vetëdijesimit dhe rritjes së përgjegjësisë së qiramarrësve/obliguesve ndaj Komunës.

Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Pajtohen)

3 Informacion i përmbledhur për planifikimin dhe realizimin e buxhetit

Në këtë kapitull kemi prezantuar një informacion të përmbledhur për burimet e fondeve buxhetore, shpenzimin e fondeve dhe të hyrave të mbledhura, sipas kategorive ekonomike. Kjo është ilustruar përmes tabelave dhe grafikëve të mëposhtëm:

Tabela 1. Shpenzimet sipas burimeve të fondeve buxhetore (në €)

| Përshkrimi | Buxheti fillestar | Buxheti final ⁵ | 2023 Shpenzimet | 2022 Shpenzimet | 2021 Shpenzimet |
|------------------------------|-------------------|----------------------------|--------------------|--------------------|--------------------|
| Burimet e fondeve | 33,290,700 | 41,360,330 | 40,240,828 | 28,763,576 | 28,071,128 |
| Grante Qeveritare - Buxheti | 28,090,203 | 32,476,534 | 32,105,989 | 23,455,986 | 23,398,357 |
| Financimi përmes huamarrjes | 0 | 0 | 0 | 251,913 | 68,088 |
| Të bartura nga viti i kaluar | 0 | 3,234,329 | 3,204,030 | 1,581,174 | 873,599 |
| Të hyrat vetanake | 5,200,497 | 5,200,497 | 4,638,510 | 3,194,746 | 3,586,402 |
| Donacionet vendore | 0 | 98,685 | 73,212 | 0 | 14,777 |
| Donacionet e jashtme | 0 | 350,286 | 219,087 | 279,758 | 129,905 |

Buxheti final është më i lartë se buxheti fillestar për 8,069,630€, kjo rritje është rezultat i kursimeve nga Granti qeveritar në bazë të vendimit të qeverisë për 4,386,331€, bartjes së të hyrave nga viti paraprak 3,234,329€, dhe përfitimi i fondeve nga donatorët e brendshme 98,685€ dhe të jashtëm për 350,286€.

Në vitin 2023 Komuna ka shpenzuar 97% të buxhetit final ose 40,240,828€, me realizim me të mirë se vitin e kaluar (2022 - 90%). Realizimi i buxhetit është në nivel të kënaqshëm dhe shpjegimet për pozicionin aktual janë detajuar më poshtë.

Tabela 2. Shpenzimet e fondeve sipas kategorive ekonomike (në €)

| Përshkrimi | Buxheti fillestar | Buxheti final | 2023 Shpenzimet | 2022 Shpenzimet | 2021 Shpenzimet |
|--|-------------------|-------------------|-------------------|-------------------|-------------------|
| Shpenzimet e fondeve sipas kategorive ekonomike | 33,290,700 | 41,360,330 | 40,240,828 | 28,763,576 | 28,071,128 |
| Pagat dhe mëditjet | 14,861,282 | 19,360,815 | 19,291,105 | 14,500,277 | 14,902,939 |
| Mallrat dhe shërbimet | 4,400,000 | 4,595,657 | 4,488,837 | 4,041,842 | 3,582,232 |
| Komunalitë | 932,000 | 932,000 | 909,564 | 752,993 | 764,949 |
| Subvencionet dhe transferet | 800,000 | 968,165 | 958,326 | 570,394 | 469,590 |
| Investimet Kapitale | 12,157,418 | 15,503,693 | 14,592,995 | 8,898,071 | 8,351,418 |
| Rezervat | 140,000 | 0 | 0 | 0 | 0 |

Shpjegimet për ndryshimet në kategoritë e buxhetit janë dhënë më poshtë:

- Buxheti final me buxhetin fillestar të kategoria paga dhe mëditje ishte rritur për 4,499,533€ nga Granti shtese nga Qeveria si rezultat i aplikimi te Ligjit të ri të pagave dhe pagesave nga vendimet gjyqësore;


- Buxheti final në kategorinë e mallrave dhe shërbimeve ishte rritur për 195,657€, apo 98% e buxhetit ishte shpenzuar ndërsa komunalit janë planifikuar vetëm me buxhetin final;

- Buxheti final për subvencione dhe transfere në krahasim me buxhetin fillestar ishte rritur 168,165€, përderisa realizimi ishte në masën 99% e buxhetit final;

- Buxheti final në kategorinë e investimeve kapitale në krahasim me buxhetin fillestar ishte rritur për 3,346,275€, apo 94% e buxhetit ishte shpenzuar. Po ashtu, edhe dinamika e realizimit për 20 projekte nuk është në harmoni me planifikimet sepse 3,486,074€ apo 60% e shpenzimeve nga kjo kategori janë realizuar në tremujorin e fund vitit. Rritjes së investimeve kapitale i ka kontribuar dhe pagesa prej 2,534,830€ në emër të vendimeve gjyqësore; dhe

Si rezultat i situatës pandemie me COVID-19, Komuna e Pejës kishte shpenzuar 20,725€, prej të cilave janë paguar për paga dhe mëditje ne sektorin e shëndetësisë.

Grafiku 1. Shpenzimet sipas kategorive ekonomike për vitin 2023



Të hyrat e planifikuara për vitin 2023 ishin 5,200,496 €, ndërsa janë realizuar 5,400,045€, duke tejkaluar planin për 4%. Ato kanë të bëjnë me të hyrat nga tatimi në pronë, të hyrat nga lejet e ndërimit, lejet mjedisore, taksat administrative, participimet, të hyrat nga qiraja etj.

Gjithashtu, në vitin 2023 Komuna e Pejës ka përfiturar të hyra nga gjobat në trafik dhe gjykatave në vlerë 882,704€. Këto të hyra nuk janë të përfshira në tabelën e mëposhtme për arsye se këto i planifikon dhe i realizon Ministria e Punëve të Brendshme, ndërsa komunës i alokohen për shpenzime.

Tabela 3. Të hyrat (në €)

| Përshkrimi | Buxheti fillestar | Buxheti final | 2023 Pranimet | 2022 Pranimet | 2021 Pranimet |
|---------------------------|-------------------|------------------|------------------|------------------|------------------|
| Totali i të hyrave | 5,200,497 | 5,200,497 | 5,326,833 | 4,753,464 | 4,907,146 |
| Të hyrat tatimore | 3,157,372 | 3,157,372 | 2,761,006 | 2,354,504 | 2,455,933 |
| Të hyrat jo tatimore | 2,043,125 | 2,043,125 | 2,565,827 | 2,398,960 | 2,451,213 |

4 Progresi në zbatimin e rekomandimeve

Raporti i auditimit për PFV-të e vitit 2022 për Komunën e Pejës ka rezultuar me tete (8) rekomandime kryesore. Komuna kishte përgatitur një Plan Veprimi ku paraqitet mënyra se si do t'i zbatoj rekomandimet e dhëna. Raporti i auditimit për vitin 2022 si dhe plani i veprimit për adresimin e rekomandimeve është diskutuar në Kuvendin Komunal të Pejës.

Deri në fund të auditimit tonë për vitin 2023, gjashtë rekomandime nuk janë adresuar ende deri sa një në proces të zbatimit dhe një nuk është i aplikueshëm, siç është paraqitur në Grafikon 2, më poshtë. Për një përshkrim më të plotë të rekomandimeve dhe mënyrën se si janë trajtuar ato, shihni në Tabelën e rekomandimeve nr. 4.

Grafiku 2. Progresi në zbatimin e rekomandimeve të vitit paraprak




Tabela 4 Përmbledhja e rekomandimeve të vitit paraprak

| Nr | Fusha e Auditimit | Rekomandimet e vitit 2022 | Veprimet e ndërmarra | Statusi |
|----|-------------------------|--|--|----------------------------|
| 1. | Baza për konkluzion | Kryetari duhet të sigurojë disiplinën financiare që procesi i realizimit të pagesave të bëhet brenda afateve kohore të përcaktuar me bazën ligjore. | Ky rekomandim nuk është i aplikueshem. | Nuk është i aplikueshem më |
| 2. | Baza për konkluzion | Kryetari duhet të rishikoj shkaqet e mos përdorimit të sistemit e-prokurimi dhe të ndërmarrë masa shtesë të kontrollit apo nevojave tjera, për tu siguruar që menaxhimi i kontratave do të mbahet dhe arkivohet në sistemin elektronik të prokurimit publik. | Nuk janë ndërmarrë veprimet e nevojshme. | Nuk ka filluar zbatimin |
| 3. | Baza për konkluzion | Kryetari duhet të sigurojë që, përmes menaxherit të prokurimit, si dhe menaxherëve të kontratave, se realizimi i kontratave bëhet në përputhje me planin dinamik/afatin për kryerjen e punëve/furnizimeve dhe për vonesat e pa arsyetuara, të aplikohen masat e parapara në kontratë. | Nuk janë ndërmarrë veprimet e nevojshme. | Nuk ka filluar zbatimin |
| 4. | Baza për konkluzion | Kryetari duhet të sigurojë se caktohen zyrtar përgjegjës të cilët duhet kujdesen për monitorimin e implementimit të projekteve. Po ashtu të sigurojë se OJQ-të përfituese të subvencioneve dorëzojnë raporte financiare dhe narrative. | Nuk janë ndërmarrë veprimet e nevojshme. | Nuk ka filluar zbatimin |
| 5. | Investimet kapitale | Kryetari duhet të sigurojë që janë ndërmarrë të gjitha veprimet e nevojshme që shpenzimet të planifikohen në ndarjet adekuate të buxhetit apo të bëhet ridestini i mjeteve dhe që pagesa dhe regjistrimi i shpenzimeve të bëhet sipas kodeve ekonomike adekuate të përcaktuara me plan kontabël. | Nuk janë ndërmarrë veprimet e nevojshme. | Nuk ka filluar zbatimin |
| 6. | Pasuritë | Kryetari duhet të sigurojë se të gjitha pasuritë e komunës janë regjistruar saktë në regjistrat përkatës të pasurive komunale, sipas kërkesave të Rregullores 02/2013 për menaxhimin e pasurive jo financiare në organizatat buxhetore. | Nuk janë ndërmarrë veprimet e nevojshme. | Nuk ka filluar zbatimin |
| 7. | Llogaritë e arkëtueshme | Kryetari, duhet të sigurojë efikasitet më të lartë në arkëtimin e llogarive të arkëtueshme. Hartimi dhe aplikimi i programeve dhe procedurave të qarta për mënyrën e menaxhimit, regjistrimit dhe arkëtimit të tyre, do të ishin disa nga masat që mund të sjellin përmirësime. | Janë ndërmarrë veprime të pjesëshme. | Pjesërisht i zbatuar |
| 8. | Obligimet e papaguara | Kryetari të sigurohet që të gjitha faturat dhe detyrimet financiare paguhen brenda afatit ligjor dhe punët apo furnizimet të bëhen vetëm atëherë kur komuna paraprakisht i siguron fondet apo ndan mjetet buxhetore të mjaftueshme për pagesë. | Nuk janë ndërmarrë veprimet e nevojshme. | Nuk ka filluar zbatimin |

Vlora Spanca, Auditore e Përgjithshme



Agron Fetiu, Ndhmës Auditor i Përgjithshëm



Ramadan Gashi, Drejtor i Auditimit



Florim Maliqi, Udhëheqës i ekipit



Luljeta Morina, Anëtare e ekipit



Edon Kabashi, Anëtar i ekipit



Shtojca I: Letër konfirmimi

Leter-konfirmimi - Peje



LETËR E KONFIRMIMIT

Për pajtueshmërinë me gjetjet e Auditorit të Përgjithshëm për vitin 2023 dhe për zbatimin e rekomandimeve

Për: Zyrën e Kombëtare të Auditimit

Të nderuar,

Përmes kësaj shkrese, konfirmoj se:

- kam pranuar draft raportin e Zyrës Kombëtare të Auditimit për auditimin e Pasqyrave Financiare të KK-Pejë për vitin 2023 (në tekstin e mëtejshëm "Raporti");
- Pajtohem me gjetjet.
- brenda 30 ditëve nga pranimi i Raportit final, do t'ju dorëzoj një plan të veprimit për zbatimin e rekomandimeve, i cili do të përfshijë afatet kohore dhe stafin përgjegjës për zbatimin e tyre.

Z. Gazmend Muhaxheri, Kryetar i

Data: 14 qershor 2024



Shtojca II: Shpjegim lidhur me llojet e të ndryshme të opinionëve të aplikuara nga ZKA dhe pjesëve të tjera të Raportit të Auditimit

Raporti i auditorit për pasqyrat financiare⁶ duhet të përmbajë një opinion për pasqyrat financiare, bazuar në përfundimet e nxjerra nga dëshmitë e marra gjatë auditimit. Kur auditimi kryhet për të vlerësuar gjithashtu përputhjen me legjislacionin dhe rregulloret e tjera, auditorët kanë një përgjegjësi shtesë për të raportuar për pajtueshmërinë me autoritetet⁷, duke rezultuar me konkluzion mbi pajtueshmërinë.

Për të arritur në përfundimin se një opinion mbi pasqyrat financiare është i modifikuar ose i pa modifikuar, një auditor duhet të sigurohet që rezultatet e auditimit përfshijnë, apo jo, keq-deklarim (e) material(e) ose të përhapur(a), apo të tillë(a) të mundshëm(me), të supozuar në rast kufizimi të fushëveprimit.

Keq-deklarimi është një ndryshim mes shumës së raportuar, klasifikimit, prezantimit ose zbulimit të një zëri të pasqyrës financiare dhe sasisë, klasifikimit, prezantimit ose zbulimit që kërkohet që zëri të jetë në përputhje me kornizën e raportimit financiar në fuqi. Keq-deklarimet mund të vijnë nga gabimi ose mashtrimi.

(shkëputur nga SNISA 200)

Forma e opinionit

Opinion i pa-modifikuar

Formulohet kur nuk janë zbuluar keq-deklarime ose mos-pajtueshmëri; kur janë zbuluar keq-deklarime ose mos-pajtueshmëri, qoftë një i vetëm apo një grumbull, por që nuk është i barabartë me ose nuk e tejkalon nivelin e materialitetit për pasqyrat financiare si tërësi; ose kur keq-deklarimi(et) dhe/ose mos-pajtueshmëria e zbuluar brenda një klase të caktuar transaksionesh nuk është e barabartë me ose e tejkalon nivelin e materialitetit më të ulët të vendosur për këtë klasë të transaksioneve. Formulohet gjithashtu nëse nuk ka kufizim të fushëveprimit ose kur kufizimi i fushëveprimit nuk mund të shpie në shmangie të keq-deklarimit(eve) material(e) dhe/ose mos-pajtueshmërisë(ve).

Kufizimi i fushëveprimit ndodh kur një auditor nuk është në gjendje të marrë dëshmi të mjaftueshme auditimi për të arritur në përfundimin se pasqyrat financiare në tërësi nuk përmbajnë keq-deklarime materiale.

Auditori duhet të japë **opinion të pa-modifikuar** nëse arrin në përfundimin se pasqyrat financiare janë përgatitur, në të gjitha aspektet materiale, në pajtim me kornizën e zbatueshme financiare.

Modifikimi i opinionit në raportin e auditorit

Auditori duhet të modifikojë opinionin në raportin e auditorit nëse konstatohet se, bazuar në dëshmitë e marra nga auditimi, pasqyrat financiare në tërësi nuk përmbajnë keq-deklarime materiale dhe/ose mos-pajtueshmëri, ose nuk është në gjendje të sigurojë prova të mjaftueshme të auditimit për të arritur në përfundimin se pasqyrat financiare në tërësi nuk përmbajnë keq-deklarime materiale dhe/ose mos-pajtueshmëri..

Opinionit i modifikuar mund të jetë:

- I kualifikuar,
- I kundërt, ose
- Mohim opinionit

Opinionit i kualifikuar

Formulohet kur janë zbuluar keq-deklarime dhe/ose mos-pajtueshmëri, qoftë një i vetëm apo një grumbull, që janë të barabartë me ose e tejkalojnë nivelin e materialitetit për pasqyrat financiare si tërësi; ose kur keq-deklarimi dhe/ose mos-pajtueshmëria e zbuluar brenda një klase të caktuar transaksionesh është i barabartë me ose tejkalon nivelin e materialitetit më të ulët të vendosur për këtë klasë të transaksioneve. Formulohet gjithashtu nëse ka kufizim të fushëveprimit, i cili mund të mos shpie në shmangie të keq-deklarimit(eve) material(e).

Opinionit i kundërt

Formulohet kur janë zbuluar keq-deklarime dhe/ose mos-pajtueshmëri, qoftë një i vetëm apo një grumbull, që tejkalon në mënyrë të përhapur nivelin e materialitetit për pasqyrat financiare si tërësi; ose kur keq-deklarimet dhe/ose mos-pajtueshmëritë e zbuluara brenda një klase të caktuar transaksionesh e tejkalojnë në mënyrë të përhapur nivelin e materialitetit më të ulët të vendosur për këtë klasë të transaksioneve.

“E përhapur” është term që përdoret, në kontekstin e keq-deklarimeve dhe/ose mos-pajtueshmërive, për të përshkruar efektet e keq-deklarimeve dhe/ose mos-pajtueshmërisë në pasqyrat financiare; ose efektet e mundshme në pasqyrat financiare të keq-deklarimeve dhe/ose mos-pajtueshmërisë, nëse ka të tilla, që nuk zbulohen për shkak të pamundësisë për të marrë dëshmi të mjaftueshme e të duhura të auditimit. Efektet e përhapura në pasqyrat financiare janë ato që, sipas gjykimit të auditorit::

- a) Nuk kufizohen vetëm në elemente, llogari ose zëra të veçantë të pasqyrave financiare;
- b) Por nëse kufizohen si të tilla, përfaqësojnë ose mund të përfaqësojnë një pjesë të konsiderueshme të pasqyrave financiare; ose
- c) Për sa i përket shpalosjeve, janë thelbësore që përdoruesit të kuptojnë pasqyrat financiare.

Mohim i opinionit

Formulohet kur kufizimi i fushëveprimit, d.m.th. kur pamundësia për të siguruar prova të mjaftueshme të përshtatshme të auditimit, është i natyrës materiale dhe pervazive.

Paragrafët e Theksimit të Çështjes dhe paragrafët e Çështjeve të Tjera në raportin e auditorit

Nëse auditori e konsideron të nevojshme të tërheqë vëmendjen e përdoruesve në një çështje të paraqitur ose shpalosur në pasqyrat financiare, e cila është sa e rëndësishme aq edhe thelbësore që ata të kuptojnë pasqyrat financiare, por ka dëshmi të mjaftueshme e të përshtatshme se çështja nuk përmban keq-deklarime materiale në pasqyrat financiare, auditori duhet të përfshijë paragrafin e Theksimit të çështjes në raportin e tij. Paragrafi për Theksimin e Çështjes duhet t'i referohet vetëm informacionit të paraqitur ose shpalosur në pasqyrat financiare.

Paragrafi i theksimit të çështjes duhet:

- të përfshihet menjëherë pas opinionit;
- të ketë titullin 'theksim i çështjes' ose ndonjë titull tjetër të përshtatshëm;
- të përmbajë një referencë të qartë ndaj çështjes që theksohet dhe të tregojë se në ç'pjesë të pasqyrave financiare mund të gjenden shpalosjet relevante që e përshkruajnë plotësisht çështjen; dhe
- të tregojë se opinionit i auditimit nuk është modifikuar për sa i përket çështjes të theksuar.

Nëse auditori e konsideron të nevojshme të komunikojë një çështje, përveç atyre që janë paraqitur ose shpalosur në pasqyrat financiare, e cila, në gjykimin e auditorit, është e rëndësishme për përdoruesit në mënyrë që të kuptojnë auditimin, përgjegjësitë e auditorit apo raportin e auditimit, dhe me kusht që kjo nuk është e ndaluar me ligj ose rregullore, duhet të përpilohet një paragraf me titullin "Çështje të tjetra", apo ndonjë titull tjetër të përshtatshëm. Ky paragraf duhet të paraqitet menjëherë pas opinionit dhe pas çdo paragrafi të Theksimit të çështjes.

Shënimet fundore

- ¹ Pajtueshmëria me autoritetet - pajtueshmëria me të gjitha ligjet, rregullat, rregulloret, standardet dhe praktikatat e mira relevante në sektorin publik
- ² Raportet tjera janë kërkesë e nenit 8 të së Rregullores 01/2017 për Raportim Vjetor Financiar
- ³ Kolektivisht të referuara si pajtueshmëri me autoritetet
- ⁴ Çështja A dhe Rekomandimi A - nënkupton çështjet dhe rekomandimet e reja
Çështja B dhe Rekomandimi B - nënkupton çështjet dhe rekomandimet e përsëritura
Çështja C dhe Rekomandimi C- nënkupton çështjet dhe rekomandimet pjesërisht të përsëritura.
- ⁵ Buxheti Final - buxheti i aprovuar nga Kuvendi i përshtatur më pas nga Ministria e Financave
- ⁶ Pasqyrat financiare në sektorin publik përfshijnë po ashtu edhe pasqyrën(at) e ekzekutimit të buxhetit
- ⁷ Pajtueshmëria me autoritetet: pajtueshmëria me ligjet, rregulloret, standardet, apo praktikatat e mira.